

V E N D I M
Nr.454 datë 16.9.1993

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.153,
DATË 3.4.1993 "PËR KALIMIN E OBJEKTEVE TË MJETEVE KRYESORE TË
NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE SHETËRORE"**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 3.4.1993 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"Mjetet kryesore të konfiskuara nga Policia Financiare ose nga organe të tjera të caktuara me ligj, të cilat me një vendim të formës së prerë të marrë nga gjykatat ose me një mënyrë tjetër ligjore kanë kaluar në pronësi të shtetit, u shtiten personave juridikë e fizikë sipas rregullave të miratuara të prokurimit.

Përfshihet dhe me autorizim të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë ato u kalohen pa pagesë vetëm institucioneve buxhetore, qendrore ose lokale".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi